



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

***Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore***

*Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë. E-mail: klsh.org.al; web-site www.klsh.org.al*

Nr. 605/5 Prot.

Tiranë, më 23.12.2019

**V E N D I M**

**Nr. 155, Datë 23.12.2019**

**PËR**

**AUDITIMIN FINANCIAR, TË USHTRUAR NË BASHKINË KRUIJË**

**PËR PERIUdhËN 01.01.2017 – 30.09.2019.**

Në auditimin e ushtruar në Bashkinë Krujë me objekt: “*Mbi auditimin financiar*” për periudhën 01.01.2017 deri më 30.09.2019, rezultoi se kishte mangësi në drejtim të zbatimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në zbatimin e buxhetit, në drejtim të sistemeve të raportimit financiar, etj.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi i Departamentit, Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me qëllim përmirësimin e gjendjes.

**VENDOSA:**

**I.** Të miratoj “*Raportin Përfundimtar të Auditimit Financiar të ushtruar në Bashkinë Krujë*” sipas programit të auditimit nr. 605/1, datë 26.08.2019, për veprimtarinë nga data 01.01.2017 – 30.09.2019.

**II.** Të miratoj Opinionin e auditimit dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

## OPINIONI I AUDITIMIT

### **Për drejtimin e Bashkisë Krujë:**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Krujë, për vitet ushtrimore 2017 dhe 2018, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyra e performancës, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e fluksit të mjeteve monetare, Fondet neto, Investimet e Aktivet Afatgjata si dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

### **Opinion i kualifikuar<sup>1</sup>**

Sipas mendimit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin e Kualifikuar”, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të shoqërisë më 31 dhjetor 2018, mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Subjekti i audituar në përputhje me kërkesat etike, që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në [juridiksionin], dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit, që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISSAI 1700) Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se; pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale (por jo të përhapura), të cilat sipas mendimit tonë kanë efekt në pozicionin financiar të llogarive të Bashkisë Krujë. Për këto arsye kemi dhënë opinion të kualifikuar, sipas përshkrimit të çështjeve të trajtuara në gjetjet e raportit Përfundimtar të Auditimit.

### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Krujë.**

Drejtimi i Bashkisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Staf i drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Staf i drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare.**

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një

<sup>1</sup> Një opinion i kualifikuar jepet kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë ose kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.

opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

## A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi Bashkia Krujë nuk ka aplikuar një sistem të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar. Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), i ngritur për vitet 2017-2018-2019 nuk ka realizuar takime në lidhje me mangësitë që shqetësojnë njësinë në lidhje me menaxhimin financiar dhe kontrollin. Nuk ka raportime të dokumentuara për zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, si dhe nuk ka të miratuar një strategji të risqeve e përcaktim të koordinatorit të riskut. Në Rregulloren e Brendshme të Bashkia Krujë nuk ka përcaktuar qartë mënyrën e raportimit nga niveli me i ulët deri tek niveli me i lartë i menaxhimit si dhe detyrat e përgjegjësive të punonjësve. Nuk është kryer asnjë procedurë për menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 9 dhe neni 21 (*Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 38-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.2. Rekomandim:** Bashkia Krujë nëpërmjet Nëpunësit Autorizues dhe strukturës së Auditit të Brendshëm, të marrë masa për njohjen nga menaxhimi dhe stafi i MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, ku të përcaktoje koordinatorin e riskut me qëllim menaxhimin e riskut, si dhe të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të miratohet Rregullorja e Brendshme e re ku të përcaktohen qartë përshkrimet e detyrave dhe përgjegjësitë për çdo pozicion pune, mënyra e raportimit i tyre në mënyrë periodike pranë menaxhimit, e raportimit të dokumentuar për zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, që ato të ndihmojnë konkretisht për përmirësimin e punës dhe uljen e risqeve në punë.

### *Menjëherë e në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga Sektori i Auditimit të Brendshëm nuk janë përshkruar në mënyrë të plotë e të qartë gjetjet e konstatuara, në disa raste mungon dispozita ligjore që i referohet gjetja, ndërsa në rastet kur është dispozita ligjore nuk është saktësuar me nenet e pikat përkatëse. Gjithashtu për gjetjet e konstatuara nuk janë shprehur dhe përcaktuar përgjegjësitë. Nga ana audituesve të Bashkia Krujë nuk është aplikuar, manuali i auditimit për vlerësimin e gjetjes, pasi mungojnë elementet kryesorë si përshkrimi i situatës, ngjarjes, veprimet e gabuara dhe referimi i legjislacionit për shkeljet e konstatuara. Në auditimet e kryera nuk janë planifikuar auditime me të shpeshta dhe më të thelluara për sektorët me risk të lartë si dhe nuk është dokumentuar dhe kontrolluar si funksionon sistemi i kontrollit të brendshëm në njësitë e vartësisë apo në fusha të ndryshme të veprimtarisë së bashkisë, për këtë arsye nuk janë dhënë rekomandime se si të përmirësohen procedurat e kontrollit e të jenë më funksionale për parandalimin e mashtrimeve. Në procesin e planifikimit nuk është vlerësuar si duhet risku dhe për rekomandimet e lëna nuk është bërë analiza e tyre, pasi nuk është hartuar program i veçantë për shkallën e zbatimit të tyre, për të adresuar përgjegjësi si dhe marrje masash për rastet e konstatimeve të problematikave të trajtuar në raportet e auditimit. Kjo ka bërë që Sektori i Auditimit Brendshëm të mos e realizojë plotësisht misionin e saj për kryerjen e monitorimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. (*Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 48-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.2 Rekomandim:** Struktura e Auditit të Brendshëm, të marrë masa që të njohë dhe të ndërtojë veprimtarinë e saj konform standardeve dhe manualeve të auditimit në të gjitha fazat e auditimit, duke vlerësuar riskun që në planifikim deri në përcaktimin dhe të realizojë kontrollin e dokumentimin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm. Të sigurojë auditime cilësore dhe në raportet finale të auditimit të trajtohen qartë e saktë problematikat e konstatuara, duke formuluar gjetjet në mënyrë të plotë me të gjitha elementet si dhe të përcaktojë përgjegjësitë. Në rekomandimet e lëna të përcaktohen në mënyrë të plotë masat që duhet të merren për përmirësimin e situatës si dhe për verifikimin e shkallës së zbatimit të tyre të hartojë program të veçantë duke informuar edhe nivelet drejtuese.

#### *Menjëherë e në vijimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Krujë për periudhën objekt auditimi ka trashëguar detyrime të prapambetura që nga vitet 2010 për 9 vendime gjyqësore të kontabilizuara në llogarinë 467 “kreditorë të ndryshëm”, me objekt padie në 3 raste për shpronësime, në 1 rast për zbatim kontrate dhe në 1 rast largim nga puna, që në fund të vitit 2017 paraqiten në vlerën 22,881,556 lekë dhe në fund të vitit 2018 paraqiten në vlerën 11,865,268 lekë. Për këto procese gjyqësore të humbura Bashkia Krujë nuk ka analizuar shkaqet e lindjes së tyre dhe nuk ka marrë masat ndaj personave përgjegjës. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 2, datë 06.02. 2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika 62 dhe 102, me Udhëzimin nr. 2 datë 09.01.2015, “Vendimet gjyqësore” pika 6.1. ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar nëni 12 pikën 3 (*Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 55-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.2.Rekomandim:** Bashkia Krujë të marrë masa, që të kryejë pagesat për detyrimet e mbetura për likuidim në fund të vitit 2018 për 5 vendimet gjyqësore në vlerën 11,865,268 lekë dhe të analizojë shkaqet e të nxjerrë përgjegjësitë për krijimin e këtyre detyrimeve.

#### *Menjëherë e në vijimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i programimit, aprovimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitet 2017, 2018 dhe 8-mujorin e vitit 2019 u konstatua se:**a.** Mungojnë metodologjitë e planifikimit sipas produkteve dhe qendrave të kostos për shpenzimet dhe për të ardhurat mbi bazë resursesh e të dhënash reale për biznesin e individ që operojnë në territorin nën juridiksionin e bashkisë, të cilat ndihmojnë njësitë vendore, që jo vetëm të përllogarisin saktë nevojat për planifikim, por edhe të monitorojnë saktë dhe drejtë realizimin e objektivave të njësisë. Vetëm nëpërmjet aplikimit të këtyre metodave, institucioni (dhe si pasojë palët e interesuara) mund të zbulojë nëse aktivitetet e njësisë janë në linjë me qëllimet dhe objektivat strategjike të saj.

**b.** Buxheti për vitin 2017 për vitin 2018 paraqitet me një performancë jo e kënaqshme në lidhje me detyrimet e papaguara, të cilat janë në nivel të lartë, ku për vitin 2017 në shumën 240,440,456 lekë ose në masën 16% të shpenzimeve totale të planifikuara dhe për vitin 2018 në shumën 160,265,239 lekë ose 11% të shpenzimeve totale të planifikuara, për 8- mujorin e vitit 2019 në shumën 68,391,552 lekë ose në masën 0,4%, ndërkohë që të ardhurat për vitin 2017 janë realizuar në masën 79%, për vitin 2018 në masën 99% dhe për 8-mujorin e vitit 2019 në masën 73% , tregues që tregojnë për një planifikim të të ardhurave mbi një bazë jo reale, pasi numri dhe vlera e debitorëve të akumuluar ndër vite për taksa e tarifa vendore paraqitet në nivele të larta 1572 subjekte në shumën 232,477,780 lekë dhe 4478 familje në vlerën 3,640,000 lekë.

Fondet buxhetore të këtyre viteve paraqiten me nivel realizimi për vitin 2017 në masën 87 % , për vitin 2018 në masën 86% dhe për 8-mujorin e vitit 2019 në masën 49.6%. Në këtë nivel realizimi ka ndikuar realizimi në nivel më të ulët i shpenzimeve operative për vitin 2017 në masën 67% , për vitin 2018 në masën 73% dhe për 8-mujorin e vitit 2019 në masën 40%, po kështu dhe investimet për vitin 2017 në masën 85% , për vitin 2018 në masën 73% dhe për 8-mujorin e vitit 2019 në masën 29%.

c. Për vitet 2017, 2018 dhe 8-mujorin e vitit 2019 janë përgatitur raporte 4-mujore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe krahasimi i tyre me planifikimin e buxhetit për çdo zë të tij sipas programeve të hartuara në bazë të funksioneve të kësaj njësie vendore dhe janë paraqitur në Këshillin e Bashkisë. Këto raporte monitorimi janë raportuar vetëm në tregues sasiore, pa analizuar shkaqet dhe përcaktuar masat korrigjuese për përmirësimin e situatës. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 42,43,47,50,52 dhe 65, me UMF nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit” i ndryshuar, pikat 253,354, me UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” pikat 82-91, (Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 57-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1.Rekomandim:** Strukturat drejtuese të këtij institucioni, në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të Programeve të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme. Planifikimi i të ardhurave të bëhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare. Për uljen e borxhit në mënyrë të kontrolluar Drejtoria Ekonomike të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen në fund të vitit 2019 të faturave të pa likuiduara të prapambetura në vlerën reale 160,265,239 lekë, të hartojë një grafik, duke zbatuar radhën e pagesave.

#### *Menjëherë e në vijimësi*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i PF rezultoi se, gjendja e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në aktiv nuk rakordon me gjendjen e llogarisë kundërparti 467 “Kreditorë të ndryshëm” në pasiv për shumën e detyrimeve gjyqësore prej 11,865,268 lekë dhe shumën prej 56,122,523 leke të detyrimeve për fatura të palikujduara të vitit 2018 për shkak kufizimit nga MFE të limitit të arkës, ku kjo e fundit është përfshirë në gjendjen e llog. 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor datë 31.12.2018)”. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 42 (Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 85-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1.Rekomandim:** Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Krujë në mbyllje të vitit 2019 të kryejë me saktësi kontabilizimin e detyrimeve të lindura të konstatuara (të prapambetura) në llogarinë 467 “kreditorë të ndryshëm” dhe shpenzimeve të konstatuara në llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, duke i rakorduar ato. Për pasaktësitë e rezultuara nga auditimi i PF, të gjenden veprimet e gabuara dhe të kryhen sistemimet e nevojshme kontabël, duke i reflketuar në bilancin e vitit ushtrimor 2019.

#### *Brenda datës 31.03.2020*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i PF rezultoi se, në fund të vitit 2017 vlera prej 41.753.944 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”, gjendje e mbartur dhe në fund të vitit 2018 i përket 60 projekt-studimeve për investime të kryera, por që nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Ndërsa për aktivet jo materiale gjendje e kësaj llogarie në mbyllje të vitit 2018 në vlerë totale prej 58,416,824 lekë nuk është llogaritur amortizim në masën 15%, duke u paraqitur në PF me vlerë historike dhe jo me vlerë të mbetur neto. Nuk janë kryer veprimet kontabël përkatëse në debi të llog.209 “Amortizimi i aktiveve afatgjata jo materiale” dhe kredi e llog. 1012 “Pakësime të fondeve baze”, duke mos u prekur këto llogari për vlerën 1,169,365 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e

qeverisjes së përgjithshme” Kreu III “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 36, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël), me VKM nr 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”, Seksioni II “Aktivet e Qëndrueshme Patrupëzuar” Pika 1/b “Klasifikimi kontabël” (*Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 91-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**6.1.Rekomandim:** Drejtoria Ekonomike për llogarisë amortizimin për aktivet afatgjata jo materiale në masën 15 % me metodën lineare dhe jo me vlerë të mbetur dhe të kryejë veprimet kontabël përkatëse për vitin 2019 dhe veprimet kontabël sistemuese për vitin 2018, duke i reflektuar në hartimin e PF në mbyllje të vitit ushtrimor 2019. Gjithashtu të kryejë veprimet e sistemit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës të studim-projektiveve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktiv afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime” dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura koresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë.

*Brenda datës 31.03.2020*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i PF rezultoi se, në gjendjen e Llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione” sipas inventarit kontabël përfshihen dhe aktivet “ndërtesa e konstruksione” të NJA Thumanë, e cila paraqitet në një vlerë sintetike prej 104,595,727 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe nga pikpamja fizike. Kjo situatë është trashëguar me reformën territoriale, si rezultat i përfshirjes në bilancin e Bashkisë Krujë i bilancit të vitit 2015 të mbylljes së ish-komunës Thumanë i paraqitur me probleme dhe pa analiza për këto aktive. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 30, me VKM nr 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”, Kapitulli I “Mbajtja e kontabilitetit” pika 2/c, me UMF nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, Kreu III. “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre” (*Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 95-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**7.1.Rekomandim:** Bashkia Krujë nëpërmjet një komisioni të ngritur me specialistë të fushës të kryejë inventarizimin dhe saktësimin e aktiveve të llog. 212 “Ndërtesa Konstruksione” për NJA Thumanë dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të kryejë zberthimin e dokumentacionit të trashëguar nga ish-komuna për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, analizuar e saktësuar vlerat e paraqitura në bilancin e vitit 2015 për të cilat të bëhen sistemit e nevojshme në kontabilitet, duke rakorduar me inventarin fizik të analizuar aktiv për aktiv.

*Brenda datës 31.12.2019*

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i PF rezultoi se, gjendja e aktiveve me vlerë historike në llogarinë 215 “Mjete Transporti” në mbyllje të viteve 2017 dhe 2018 paraqitet e pandryshuar në vlerën 78,013,460 lekë. Për këto aktive është kryer inventari fizik, ku inventari kontabël nuk rakordon për vlerën prej 7,986,465 lekë të 4 automjeteve, të cilët nuk ekzistojnë fizikisht, pasi 2 automjete janë shitur sipas kontratave datë 06.08.2015 dhe 09.06.2017, për të cilat nuk ka kaluar pronësia tek blerësi dhe 2 automjete kanë humbur ( 1 me procedim në prokurori të pushuar me datë 18.04.2018 dhe 1 me urdhër-zhdëmtimi datë 08.08.2017 për personin përgjegjës), për të cilat nuk është kryer asnjë veprim në kontabilitet. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzim e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” dhe Kreu II. “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e

qeverisjes së përgjithshme” pika 18, me UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për Institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe Njësive që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit /zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj” i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007, Kap. II, pika 3- Procedurat e rakordimit dhe mbylljes së llogarive (*Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 101-102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**8.1. Rekomandim:** Bashkia Krujë nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike dhe Drejtorisë Juridike për 2 automjetet e shitura në vlerën 3,782,440 lekë të kryejë veprimet për kalimin e pronësisë, ndërsa për automjetet e humbura të relatojë në këshillin bashkiak për miratimin e zbritjes së vlerave të tyre prej 4,204,025 lekë nga gjendja e **llogarisë 215** “Mjete Transporti” dhe kryerjen e veprimeve kontabël të nevojshme sipas rasteve, për të saktësuar gjendjen reale të aktiveve të pasqyruara në këtë llogari.

*Brenda datës 31.12.2019*

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i PF rezultoi se, gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën bruto ose historike) për vitin 2017 në vlerën 3,937,950,020 lekë dhe për vitin 2018 në vlerën 4,049,506,593 lekë është paraqitur i plotë, pasi janë pasqyruar të gjitha shtesat dhe pakësimet për çdo lloj grup aktiv. Nga verifikimi i inventarëve kontabël rezultoi se janë azhurnuar bruto të gjithë investimet e kryera për të gjithë aktivet brenda llojit, sipas emërtesave të projekteve të investimeve, pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv. Për këto aktive mungojnë kartelat kontabël apo regjistri historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur. Këto veprime janë në kundërshtim me ne kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III, pika 30 (*Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 105-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**9.1. Rekomandim:** Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Krujë të kryejë veprimet për krijimin dhe mbajtjen e një regjistri analitik aktivesh sipas formatit, ku duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjen në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, datën e daljes nga pronësia, në formë analitike.

*Brenda datës 31.03.2020*

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i PF rezultoi se, gjendja e llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” si në mbyllje të vitit 2017 dhe në mbyllje të vitit 2018 paraqitet me gjendje 0, kur në fakt duhet të kishte të evidentuar vlerën e kapitalit të derdhur prej 500,000 lekë në bazë të 25% së zotërimit të aksioneve nga Bashkia Krujë në Shoqërinë Aksionare “K. S. K.” dhe vlerën e kapitalit të derdhur prej 3,500,000 lekë në bazë të 25% së zotërimit të aksioneve nga Bashkia Krujë në Shoqërinë Aksionare “I. (klubi i futbollit F.-K.)”. Mos evidentimi në llogarinë e aktiveve afatgjata llog. 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe në llogarinë kundërparti të saj në pasiv të bilancit llog 1011, “Shtesa të fondit bazë” ka sjellë mospasqyrim të këtyre investimeve eventuale të kryera nga Bashkia Krujë në vlerën 4,000,000 lekë, që lidhen me pjesëmarrjet me kapitalin e vet (fondet e veta) në kapitalin e shoqërive aksionere. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8 datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 31 (*Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 110-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**10.1.Rekomandim:** Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Krujë të marrë masa që në mbyllje të vitit ushtrimor 2019 të kryejë veprimet kontabël përkatëse për pasqyrimin në PF të investimeve në vlerën 4,000,000 lekë të kryera në vitet e mëparshme, që lidhen me pjesëmarrjet me

kapitalin e vet (fondet e veta) në kapitalin e shoqërive aksionere në SH.A “K. S. K.” për vlerën 500,000 lekë të kapitalit të derdhur për zotërim të 25% të aksioneve dhe SH.A “I. (klubi i futbollit F.-K.)” për vlerën 3,500,000 lekë të kapitalit të derdhur për zotërim të 100% të aksioneve.

*Brenda datës 31.03.2020*

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i PF rezultoi se, në gjendjen e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” nuk është përfshirë gjendja e llogarisë 404 “Furnitorë e llogari të lidhura me to ( për investime)”, e cila paraqitet me gjendje 0, pasi në kontabilizimet e shpenzimeve për investime nuk është prekur kjo llogari detyrimesh, por një pjesë janë kontabilizuar në llogarinë 467 “kreditorë të ndryshëm”, ndërsa për një pjesë të faturave të mbetura të palikujduara në fund të vitit ushtrimor 2017 në vlerën 86,525,770 lekë dhe në fund të vitit ushtrimor 2018 në vlerën 29,153,261 lekë nuk janë kryer veprimet e kontabilizimit në momentin e mbërritjes së faturës, duke mos u përfshirë në gjendjen e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” të paraqitura në bilancin e vitit 2017 dhe 2018., e cila ka sjellë një pasaktësi dhe informacion jo real kontabël në mbyllje të PF të vitit 2017 dhe 2018 për detyrimet e Bashkisë Krujë ndaj të tretëve. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 ”Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III pika 32 (*Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 117-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**11.1. Rekomandim:** Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Krujë të kryejë veprimet e kontabilizimit në rastet e kryerjes së investimeve në momentin e mbërritjes së faturës dhe çeljes së fondeve, për njohjen dhe realizimin e investimeve, duke prekur llogaritë përkatëse në mënyrë që, në fund të vitit të ushtrimor të paraqiten në bilanc detyrimet reale ndaj të tretëve në llogaritë e detyrimeve.

*Menjëherë e në vijimësi*

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga testimi kryer për kontabilizimin e kontratave rezultoi se, për vitet 2017-2018-2019 për 104 kontrata të lidhura në vlerën 1,596,939,989 lekë për blerje aktivesh materiale dhe jo materiale, si mallra apo projekte investimesh, nuk është kryer kontabilizimi i veprimeve ekonomike as në momentin e çeljes së fondeve, as në momentin e mbërritjes së faturave. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve ekonomike të kryera nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por thjesht kur kryhet pagesa, Nuk janë kryer veprimet kontabël në kohën e lindjes të detyrimit për t'u paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin pagesa, dhe që kanë sjellë për ushtrimin e dhënë shpenzime. Po kështu nuk janë kryer veprimet përkatëse kontabël në lidhje me fondet buxhetore të përdorura për investime në momentin e kapitalizimit të aktivitetit. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël” Kapitulli I, pika 1. me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 ”Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III pika 32 (*Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 129-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**12.1. Rekomandim:** Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Krujë të kryejë të gjitha veprimet e kontabilizimit sipas fazave të kryerjes së veprimeve ekonomike për kontratat e lidhura për blerje aktivesh afatgjata materiale dhe jo materiale, për të pasqyruar të gjitha detyrimet financiare të lindura nga angazhimi i krijuar që nga çelja e fondeve, me konstatimin e shpenzimit (mbërritja e faturës), deri në kapitalizimin e aktivitetit dhe jo thjesht, kur ndërhyr pagesa, pasi evidentimi i saktë i detyrimeve ndaj të tretëve është i domosdoshëm për njohjen reale të borxhit të akumuluar dhe marrjen e masave për zvogëlimin gradual të tij.

*Menjëherë e në vijimësi*



**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës për periudhën 6-mujori i dytë viti 2017, viti 2018 dhe 8-mujori i vitit 2019 rezultoi se janë kryer pagesa me urdhër-shpenzime në 349 raste në vlerën 555,009,063 lekë mbi afatin 30 ditor të faturave për shpenzime mallra e shërbime dhe investime të mbërritura në institucion, ku një pjesë ka ndodhur dhe për shkak të kufizimit të limitit të arkës nga MFE për pagesat e vitit 2017 dhe 2018 në muajt nëntor-dhjetor dhe një pjesë nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh , kështu:

- Për investime në 19 raste në vlerën 26,782,256 lekë për vitin 2017, në 100 raste në vlerën 190,499,096 lekë për vitin 2018 dhe në 36 raste në vlerën 49,682,868 lekë për 8-mujorin e vitit 2019;

- Për shpenzime mallra e shërbime në 36 raste në vlerën 34,529,196 lekë në vitin 2017, në 115 raste në vlerën 200,968,071 lekë për vitin 2018 dhe në 43 raste në vlerën 52,547,576 lekë.

Këto veprime janë në mosrespektim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52 (*Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 138-139 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**13.1.Rekomandim:** Bashkia Krujë të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës (përjashtuar kufizimet e MFE) për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim që të mos akumulohet borxh për fatura të palikujduara dhe të evitohet në të ardhmen përfshirja në institucionit në vështirësi financiare.

#### *Menjëherë e në vijimësi*

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i dokumentacionit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH, dërguar me shkresën nr. 1005/61, datë 20.12.2018 për auditimin e ushtruar në **Bashkinë Krujë**, dhe në zbatim të planit të veprimit të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Krujë, të miratuar me shkresën nr. 7763/1 datë 10.01.2019, konstatohet se:

**a-** Mbi zbatimin e *masave organizative* të rekomanduara nga KLSH, konstatohet se nga 19 masa organizative, janë pranuar të gjitha, janë zbatuar plotësisht 10 masa, 9 masa janë në proces zbatimi dhe nuk ka masa organizative të pazbatuara.

**b-** Mbi zbatimin e *masave shpërblim dëmi*, të rekomanduara nga KLSH, konstatohet se nga 15 masa me vlerë 12,339,075 lekë, është pranuar dhe kontabilizuar e gjithë vlera, janë zbatuar plotësisht 3 masa në vlerën 354,886 lekë, janë në proces zbatimi 5 masa nga të cilat janë arkëtuar 120,680 lekë dhe nuk janë zbatuar 7 masa për shpërblim dëmi. Në total, deri me datë 30.09.2019, janë arkëtuar 475,566 lekë, ndërsa shuma 11,863,509 lekë nuk është arkëtuar.

**c-** Janë rekomanduar 18 masa disiplinore, gjendja e të cilave paraqitet:

Sipas “Ligjit për Nëpunësin Civil” janë rekomanduar 13 masa disiplinore, nga të cilat nga Komisioni i Disiplinës janë dhënë 10 masa disiplinore “Vërejtje” dhe është ndërprerë fillimi i ecurisë disiplinore për 3 punonjës.

Sipas “Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë” janë rekomanduar 5 masa disiplinore, për të cilat Kryetari i Bashkisë Krujë ka nxjerrë urdhrat për masën disiplinore “Vërejtje” për 4 punonjës dhe për 1 punonjës ka vendosur mos marrjen e masës disiplinore.

**d-** *Agjencia e prokurimit publik*; me vendimin nr. 03, datë 19.01.2018, ka vendosur masën dënim me gjobë për 9 persona në vlerën në total prej 2,150,000 lekë. Në vijim nga punonjësit e ndëshkuar me gjobë nga APP është bërë kërkesë padi në GJA të Shkallës së parë Tiranë. Me vendimin nr. 1103, datë 20.02.2018, të GJA të Shkallës së parë Tiranë, është pranuar kërkesë padija dhe shfuqizuar vendim nr. 3, date 19.01.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik, ku për Paditësit Anila Haxhi, Genc Halili, Eni Caka, Sabije Seseri, Florind Cerhozi, Iva Hoxha, Ergys Sallaku dhe Riza Blushi, ky vendim është i formës së prerë, ndërsa për paditësen Aida Dedja, kundër këtij vendimi lejohet ankimimi brenda 15 ditëve në GJA të Apelit Tiranë.

**e-** I janë rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Krujë t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrotjtjes së Territorit Vendor të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara për 3 persona.

Rezultoni se Kryeinspektori i IMTV me vendimin nr. 01, datë 18.01.2018, nr. 02, datë 18.01.2018 dhe nr. 03, datë 18.01.201, i cili është protokolluar në Bashkinë Krujë me shkresën (njoftim mbi masë administrative) nr. 511, nr. 512, nr. 513, prot., datë 29.01.2018, duke vendosur masë dënimi me gjobë për 3 persona me nga 50,000 lekë secili, dhe Bashkia Krujë i është drejtuar GJA të Shkallës së Parë Krujë, “Kërkesë për lëshim urdhër ekzekutimi të masës administrative dënimi me gjobë të nxjerrë nga IMTV, Bashkia Krujë”, me shkresat nr. 3145, nr. 3146, datë 23.05.2018 dhe shkresën nr. 3304, datë 31.05.2018 (*Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 168 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**14.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Krujë të hartojë *menjëherë* plan pune dhe të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për rizbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara ose në proces zbatimi të KLSH në auditimin e mëparshëm, dërguar me shkresën nr. 1005/61, datë 20.12.2018, respektivisht: a) Për 9 masa organizative, respektivisht pikat: 5; 7; 9; 11; 12; 13; 14; 18 dhe 19; b) Për 12 masa shpërblim dëmi në vlerën 11,863,509 lekë, respektivisht pikat: 1; 2; 3; 4; 5; 6; 7; 10; 12; 13; 14 dhe 15.

*Menjëherë*

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i dokumentacionit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH, dërguar me shkresën nr. 1005/62, datë 20.12.2018 për auditimin e ushtruar në **ish-Bashkinë Fushë Krujë** dhe 4 ish-Komunat **Thumanë, Nikel, Bubq** dhe Cudhi, në zbatim të planit të veprimit të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Krujë, të miratuar me shkresën nr. 7763/1 datë 10.01.2019, konstatohet se:

**a.** Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 9 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 9 masa, nga të pranuarat janë zbatuar 8 masa dhe është në proces zbatimi 1 masë organizative dhe nuk ka masa organizative të pa zbatuara.

**b.** Janë rekomanduar 6 masa disiplinore, gjendja e të cilave paraqitet;

-Sipas “Ligjit për Nënuesin Civil” janë rekomanduar 6 masa disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në 1 vit” e parashikuar në nenin 58, germa “c”, nga verifikimi rezultojë se nga ana e Komisionit disiplinor janë marrë 3 masa dhe është ndërprerë fillimi i ecurisë disiplinore për 3 punonjës të tjerë (*Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 173 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**15.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Krujë të hartojë *menjëherë* plan pune dhe të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për rizbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara ose në proces zbatimi të KLSH në auditimin e mëparshëm, dërguar me shkresën nr. 1005/62, datë 20.12.2018, respektivisht: Për 1 masë organizative, dhe konkretisht masën nr. 4.

*Menjëherë*

## **B. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DUKE RRIUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA DËNIMET PËR KUNDRAVAJTJE ADMINISTRATIVE.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumenteve dhe të dhënave të paraqitura nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, ndër vite nga ish Komunat janë përcjelle detyrime tatimore të subjekteve që kanë ushtruar veprimtari biznesi pa qenë të regjistruar në QKR. Buxhetit të Bashkisë për periudhën objekt auditimi nga mos regjistrimi në QKR i 127 subjekteve, llogarit mungesë të ardhurash me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë në vlerën 7,755,963 lekë e ndarë: NjA Krujë për 20 subjekte në vlerën 1,305,630 lekë, NjA Fush-Krujë për 5 subjekte në vlerën 155,068 lekë, NjA Bubq për 51 subjekte në vlerën 4,207,950 lekë dhe NjA Nikël, për 51 subjekte në vlerën 2,087,315 lekë. që përbëjnë të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar ,neni 40 e 41 (*Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 66-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1.Rekomandim:** Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Krujë të marrë masa, të njoftojë zyrtarisht Drejtorinë Rajonale Tatimore duke kërkuar regjistrimin e 127 subjekteve në QKR

dhe të kërkojë në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e detyrimeve në vlerën 7,755,963 lekë, të cilët kanë ushtruar aktivitet të pa licencuar.

### *Menjëherë e në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Krujë dhe 4 Njësitë Administrative Fushë Krujë, Thumanë, Nikel dhe Bubq, në fund të vitit 2018 janë debitorë për taksa dhe tarifa vendore 1572 subjekte në shumën 232,477,780 lekë dhe 4478 familje në vlerën 3,640,000 lekë. Drejtoria e Tatim Taksave për arkëtimin e debitorëve nuk ka ndjekur procedurat e nevojshme ligjore, veprim në kundërshtim me nenin 4, 26, 32, 34, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, nenet 90, 91, të ligjit nr. 9920 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe nenin 12, të UMF nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve (*Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 68-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1. Rekomandim:** Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Krujë të merren masa, për arkëtimin e detyrimeve tatimore dhe të bëhen njoftim vlerësimet tatimore, për 1572 subjekte debitorë në shumën 232,477,780 lekë, bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

**a** - Tu dërgohen bankave urdhra bllokimi për llogaritë bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

**b** - Të dërgoj në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

**c** - Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, të llogaritet kamat vonesa (gjobë në masën 0,06 % kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

**d**-Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, bazuar në nenin 182, të ligjit të Kodit Penal në RSH i ndryshuar, pasi të vendosen masa administrative të bëhet kallëzim penal.

Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Krujë, të listohen në mënyrë elektronike abonentët familjarë dhe të merren masa për arkëtimin e taksave të tokës për vlerën 3,640,000 lekë, të ndarë si më poshtë:

- Njësia Administrative Fushë Krujë, taksë toke për 902 familje me vlerë 757,000 lekë;
- Njësia Administrative Thumanë, taksë toke për 1719 familje me vlerë 1,244,000 lekë;
- Njësia Administrative Nikël, për 1045 familje me vlerë 995,000 lekë;
- Njësia Administrative Bubq për 812 familje me vlerën 644,000 lekë.

**a**- Në zbatim të pikës 71, të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, të njoftohen tatimpaguesit familjarë me njoftim vlerësimi tatimor edhe në median lokale të Bashkisë për të paguar detyrimin tatimor. Njoftim Vlerësimet t’ju dërgohen nëpërmjet Zyrës Postare, për të gjitha llojet dhe shumën e taksave të papaguara, si taksën e tokës, ndërtesës dhe tarifata të tjera të papaguara.

### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Krujë nuk ka ndjekur në rrugë ligjore me padi në gjykatë për 38 raste “dënim me gjobë” për ndërtime pa leje në vlerën 11,900,000 lekë, duke sjellë një efekt negativ në buxhetin e kësaj njësie vendore nga mungesa e këtyre të ardhurave në kundërshtim me ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” nenet 20, 30 dhe ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, të ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1.Rekomandim:** Bashkia Krujë, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor dhe Drejtoria Juridike të marrë masat dhe të kërkojë në Gjykatë rivendosjen në afat për 38 vendime me gjobë për ndërtimet e kundërligjshme, të vendosura gjatë vitit 2015-9/M i vitit 2019, në vlerën 11,900,000 lekë, bazuar në nenet 151 dhe 152 të “Kodit Procedurës Civile në RSH”. Njëherazi të marrë masa për kthimin e vendimeve të gjobave në tituj ekzekutiv në zbatim të nenit 24 - Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

*Menjëherë e në vijimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Krujë nuk është kryer arkëtimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI- Drejtoria Rajonale Krujë, me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën 5,204,681 lekë në kundërshtim me ligjin nr. 9482 datë 03.04.2016, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar me ligjin nr. 50/2014 neni 23, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, neni 35, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës se mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar *Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**4.1.Rekomandim:** Zyra e Taksave, Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Urbanistikës, Planifikimit të Territorit, Bashkia Krujë, të marrë masat, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 5,204,681 lekë e ardhur e munguar nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore të legalizuara.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

## **C. MASA DISIPLINORE:**

### **Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil dhe me kontratë pune.**

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; germat (b, c, ç) e nenin 58-“*Llojet e masave disiplinore*”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”; neni 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”; shkronja (b) e nenit 9- “*Masa disiplinore*”, të kontratës individuale, dhe shkronja (k) e nenit 64, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Krujë që t’i kërkojë Komisionit Disiplinor**, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore për 2 punonjës si më poshtë :

***b-“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, neni 58 shkronja (c), për 2 (dy) punonjës si më poshtë:***

**1. Zj. Xh. Xh.** me detyrë ish-Drejtoresh Finance për periudhën (01.01.2017- 31.12.2019) aktualisht specialiste në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, për shkeljet e konstatuara:  
- Në gjendjen e llogarisë 468 “*Debitorë të ndryshëm*” gjendja e debitorëve për taksa dhe tarifa vendore në vlerën 220,765,156 lekë në fund të vitit 2017 dhe në vlerën 234,637,226 lekë në fund të vitit 2018 si dhe përfshirja në formatin e performancës financiare të PF i të ardhurave të krijuara është bërë nga jashtë nga evidencat e mbajtura (databaze) nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore,  
- Gjendja e llogarisë 486 “*Shpenzime të periudhave të ardhshme*” në aktiv nuk rakordon me gjendjen e llogarisë kundërparti 467 “*Kreditorë të ndryshëm*” në pasiv për shumën e detyrimeve gjyqësore prej 11,865,268 lekë dhe shumën prej 56,122,523 leke të detyrimeve për fatura të palikujduara të vitit 2018 për shkak kufizimit nga MFE të limitit të arkës, ku kjo e

fundit është përfshirë në gjendjen e llog. 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor datë 31.12.2018)”.

- Në mbyllje të vitit 2018 për aktivet jo materiale llogaria 202 “Studime dhe kërkime” të paraqitur me gjendje në vlerën prej 58,416,824 lekë nuk është llogaritur amortizim në masën 15% , duke u paraqitur në PF me vlerë historike dhe jo me vlerë të mbetur neto. Nuk janë kryer veprimet kontabël përkatëse në debi të llog.209 “Amortizimi i aktiveve afatgjata jo materiale” dhe kredi e llog. 1012 “Paksime te fondeve baze”,duke mos u prekur këto llogari për vlerën 1,169,365 lekë.

- Në fund të vitit 2017 vlera prej 41.753.944 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”, gjendje e mbartur dhe në fund të vitit 2018 i përket 60 projekt-studimeve për investime të kryera, por që nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme

- Në gjendjen e Llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione” sipas inventarit kontabël përfshihen dhe aktivet “ndërtesa e konstruksione” të NJA Thumanë, e cila paraqitet në një vlerë sintetike prej 104,595,727 lekë e pa analizuar si në kontabilitet ashtu dhe në gjendje fizike.

- Gjendja e llogarisë 215 “Mjete Transporti” në mbyllje të viteve 2017 dhe 2018 paraqitet e pandryshuar në vlerën 78,013,460 lekë. Për këto aktive është kryer inventari fizik, ku inventari kontabël nuk rakordon për vlerën prej 7,986,465 lekë të 4 automjeteve, të cilët nuk ekzistojnë fizikisht, pasi 2 automjete janë shitur me ankand dhe nuk ka kaluar pronësia tek blerësi dhe 2 automjete kanë humbur, për të cilat nuk është kryer asnjë veprim në kontabilitet.

- Janë azhornuar bruto të gjithë investimet e kryera për të gjithë aktivet brenda llojit sipas emërtesave të projekteve të investimeve pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv.

- Gjendja e llogarisë 26 “Pjesmarrje në kapitalin e vet” si në mbyllje të vitit 2017 dhe në mbyllje të vitit 2018 paraqitet me gjendje 0, kur në fakt duhet të kishte të evidentuar vlerën e kapitalit të derdhur prej 4,000,000 lekë lekë, duke sjellë humbjen e këtyre investimeve eventuale të kryera nga Bashkia Krujë në vlerën, që lidhen me pjesëmarrjet me kapitalin e vet (fondet e veta) në kapitalin e shoqërive aksionere “K. S. K.”dhe “I. (klubi i futbollit F.-K.)”.

- Në gjendjen e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” nuk është përfshirë gjendja e llogarisë 404 “Furnitorë e llogari të lidhura me to ( per investime)”, për një pjesë të faturave të mbetura të palikujduara në fund të vitit ushtrimor 2017 në vlerën 86,525,770 lekë dhe në fund të vitit ushtrimor 2018 në vlerën 29,153,261 lekë, për të cilat nuk janë kryer veprimet e kontabilizimit, duke sjellë një pasaktësi dhe informacion jo real kontabël për detyrimet e Bashkisë Krujë ndaj të tretëve.

- Për vitet 2017-2018-2019 për 104 kontrata të lidhura në vlerën 1,596,939,989 lekë për blerje aktivesh materiale dhe jo materiale, nuk është kryer kontabilizimi i veprimeve ekonomike as në momentin e çeljes së fondeve, as në momentin e mbërritjes së faturave, por thjesht kur ndërhyjnë pagesa. Po kështu nuk janë kryer veprimet përkatëse kontabël në lidhje me fondet buxhetore të përdorura për investime në momentin e kapitalizimit të aktivit.

Këto veprime nuk përputhen me parimet e kontabilitetit të pranuar, ligjit organik të buxhetit, si dhe kërkesat e: VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”Kapitulli I,pika 1, 2/c, Seksioni II Pika 1/b, me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 ”Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu I pika 8,32,83,84,85, Kreu II pika 2/a,b,pika 22, pika 15/a,b,c,18/a,b,Kreu III, pika 28, 31,32,36,42, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, me UMF nr.30 datë 27.12.2011“Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kreu III, pika 30.

**2. Zj.L. T.** me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore për shkeljet e konstatuara:

- Nga ish Komunat ndër vite janë përcjelle detyrime tatimore të subjekteve që kanë ushtruar veprimtari biznesi pa qenë të regjistruar në QKR. Nga mosregjistrimi në QKR i 127 subjekteve, llogarit mungesë të ardhurash me efekt negativ në vlerën 7,755,963 lekë, në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar ,neni 40 e 41.

- Në Bashkinë Krujë dhe 4 Njësitë Administrative Fushë Krujë, Thumanë, Nikel dhe Bubq, në fund të vitit 2018 janë debitorë për taksa dhe tarifa vendore 1572 subjekte në shumën 232,477,780 lekë dhe 4478 familje në vlerën 3,640,000 lekë. Drejtoria e Tatim Taksave për arkëtimin e debitorëve nuk ka ndjekur procedurat e nevojshme ligjore, në kundërshtim me nenin 4, 26, 32, 34, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, nenin 90, 91, të ligjit nr. 9920 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe nenin 12, të UMF nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve.

- Nuk është kryer arkëtimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI- Drejtoria Rajonale Krujë, me pasojë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën 5,204,681 lekë në kundërshtim me ligjin nr. 9482 datë 03.04.2016, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar me ligjin nr. 50/2014 neni 23, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, neni 35, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar.

#### **D. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL:**

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër (Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit) , pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

**1.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 ”Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

**2.** Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 ”Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

#### **E. SHËNIM I KRYETARIT TË KLSH**

Auditimi është realizuar me mangësi dhe konkretisht, sipas dokumentit 16.4 datë 20.12.2019 të Drejtores së Përgjithshme:

“**a.** Auditimi nuk është realizuar në përmbushje të objektivave të tij.(Mënyra e përzgjedhjes së kampionit reflekton problematika të modelit të vjetër të auditimit të bazuar në zgjedhje rastësore duke mos dhënë garanci që të gjitha risqet janë identifikuar dhe procedurat e auditimit janë të përshtatshme për dhënien e një opinionit bazuar në standarde).

**b.** Auditimi nuk është kryer në përputhje me standardet e auditimit të adoptuara nga INTOSAI. Procesi i planifikimit të auditimit dhe hartimi i strategjisë së auditimit referuar kërkesave të manualeve është formal për të mos thënë që mungon.

Përcaktimi i materialitetit nuk është bazuar në vlerësime paraprake dhe përdorimi i tij gjatë auditimit nuk evidentohet apo dokumentohet. Në mungesë të këtij vlerësimi nuk ka përcaktim të llojeve të testimeve të realizuara, kohën e testimeve dhe madhësinë e përshtatshme të kampionit për të arritur në konkluzione të bazuara në evidencë të plotë. Nuk është dokumentuar përshtatshmëria e kampionit për tërë popullatën. Mungon kampioni për transaksionet materiale sipas aktivitetit vjetor për periudhën në auditim, duke krijuar më pas mungesë të evidencave të përshtatshme për plotësim të objektivave të auditimit.

Gjetjet jepen të shkëputura nga adresimi i thyerjeve në proceset e kontrollit të cilat supozohet të garantojnë përputhshmërinë e aktivitetit me kuadrin ligjor në fuqi.

Në përgjithësi gjetjet nuk lidhen me shkakun kryesor dhe rekomandimet duke qenë se në disa raste janë copy paste nuk arrijnë që të forcojnë sistemet e brendshme për të eliminuar paligjshmëritë e verifikuara.

Grupi i auditimit ka patur një listë të çështjeve të cilat të kishin një trajtim të plotë dhe shterues të problematikave të lidhura me buxhetimin, zbatimin e buxheteve, detyrimet e prapambetura, angazhimet pa fonde në dispozicion, për të mos lënë mënjanë testet për zëra të bilancit të lidhura me administrimin e aktiveve dhe të drejtave që nuk administrohen apo nuk pasqyrohen saktë në pasqyrat financiare të prodhuara nga institucioni. Zona e plotësisë dhe saktësisë të kostove të personelit nuk ka reflektim as në Raport dhe as në Projektvendim. Pra deviacionet e konstatuara edhe në zona të pjesshme tregojnë për nivele materiale të devijimeve dhe të përhapura që çojnë në një opinion të kundërt lidhur me pasqyrat financiare, megjithëse trajtimi në projektvendim duhet të ishte i plotësuar edhe përsa kanë konstatuar. Mungon e reflektuar situata financiare e Bashkisë sa është e aftë të përballojë ekzistencën e saj, megjithëse e kërkuar ky aspekt nuk është arritur të plotësohet.

c. Si një Bashki e prekur nga tërmeti analiza e fondeve për emergjenca dhe përdorimi i tyre nuk është mbuluar me auditim. Megjithëse një rekomandim lidhur me mënyrën se si duhet të përballohen situata të tilla do të ishte i vlefshëm nuk arrijmë të shprehemi për mostrajtim nga audituesit.”

*Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.*

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**